



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

VENDIM

Nr. 81 Datë 27.12.2024

PËR

**MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS
02.12.2024**

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), neni 53/8, ligji nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike“, si dhe Vendimin Nr. 22, datë 25.02.2020 „Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Kukës“, neni 88,

VENDOSI

1. Të miratojë procesverbalin e mbledhjes së datës 02.12.2024 bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT

Albert MUJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS
PROCESVERBAL

Mbledhja e dates 02.12. 2024

I mbajtur sot më datë 02.12.2024, ora 11:00, u mbledh këshilli Bashkiak për mbledhjen e radhës të muajt nëntor, sipas njoftimit përkatës .

Në mbledhje morën pjesë: A.M, E.H, G.H, R.T, A.Z, D.S, A.D, Xh.V, V.B, E.B, E.Gj, V.M, A.S, F.S, M.K, A.Sh, B.LI, A.R, T.E, G.Sh, F.G, H.P, B.B, L.Gj, A.G.

Kuorumi është , vijojmë me rendin e ditës;

1) Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 8.11.2024

2) projektvendim për dhënie ndihmës ekonomike nga fondi 6%

3) projektvendi për financimin e pagesës së qirasë bashkisë së Lubeckut për një automjet të përdorur

4) Për miratim fondi për dhënie pagese për rastin e daljes në pension pleqërie

5) Projektvendim për shperblimin e sportistave të nivelit të lartë dhe tranjerëve të tyre

6) Projektvendim “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e bashkisë.

7) Projektvendim” Për zgjedhjen e përfaqesuesit të këshillit bashkiak në Këshillin e qarkut.

Të ndryshme (data e zgjedhjeve ne Mustafaj, punimet ne lagjen 6, kanalizimet lagje 4

F.G; Kërkoj të shtohet për diskutim mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore gjatë dimrit, si dhe gjendja e infrastrukturës arsimore nëpër njësi.

A.R; Kërkoj të ngrihet një komision i këshillit për monitorimin e investimeve që po kryhen në bashkinë Kukës (Lagjet që po ndërtohen etj)

Këshilli është edhe për ndërtimin e politikave

Nuk ka rikualifikim urban dhe nuk është në parametra ingjinierike .

M.K: Për lagjen 6, punimet duhet të vazhdojnë

A.G: Kërkoj që të shtohen në rend dite problemi i lokaleve në shëtitore të shikohet mundësia të behet për cdo biznes ose për asnjë .Pse shtohen objektet ? Aty është shëtitore

Gjithashtu ,rruga Mgullë-Shtanë-Shikaj,është në gjendje të keqe, duhet të ndërhyhet. Gjithashtu është marrë një vendim për urën e vjetër . Pse nuk zbatohet?

F.G:Të raportohet ritmikisht një herë në muaj gjendja e infrastrukturës ,institucionet arsimore,institucionet shëndetsore,furnizimi me ujë ,furnizimi me energji elektrike deri në mars të 2025

Lidhur me urën ,duhet të kërkojme informacin

Vijohet me miratimin e rendit të ditës.Miratohet .

Fillojmë me diskutimin pikë për pikë.

Pika 1. Procesverbali i dt 8 nëntor . Miratohet

Pika 2.Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi 6%

G.H: Është mbledhur korumi ,është conform ligjit ,janë shtuar 13 familje më shumë .Ne si komision kërkuam përfshirjen e një familje me probleme sociale dhe ekonomike të z.B.C

Nuk ka diskutime të tjera . Miratohet (1 abstenim) F.G

Pika 3.Për miratimin e financimit të pagesës së qerasë bashkisë së lubeckut.

G.H;Bashkia e lubeckut i ka ofruar bashkisë tonë një makineri për pastrimin e mbetjeve me një qera vjetore rreth 5000 mijë euro.pas 2 viteve kjo makineri do të behet dhuratë në fund të dy viteve .

A.G; Para 2 vitesh është bërë një propogandë se na janë dhuruar disa makineri.Ku janë /

Z.M :Flitet për makineri ekologjike

Ne kemi disa kosha .Kjo makineri na kryen punë.Kjo vlerë në projektvendim përfshin dhe pagesat doganore.hidhet në votim .Miratohet.(A kundër ,H kundër ,F abstenim)

Pika 4:për dhenie pagese per daljen në pension pleqërie.

A- a kanë qenë dakort?

Hidhet në votim miratohet

Projekt vendim për shpërblimin e sportistave të nivelit të lartë dhe tranjerët e tyre.

I.K:Nuk ka përjashtime ,janë perfshirë vetëm ekipet kampion. Tranjeri ben një punë shumë të madhe.

F.G: Kam kërkuar në shpërblimin e parë, këta trajnesë a sjellin objektivat dhe a i kanë realizuar ato?

I.K: Sportistat duhen mbështetur.

H.P: Cfarë profesioni ka trajneri?

I.K: Jemi përfaqësuar në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare në mundje.

Hidhet në votim dhe miratohet. 1 abstenim (E.H), të tjerat pro.

Pika 6. Projektvendim “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit për vitin 2024.

G.H: E kemi shqyrtuar në mbledhje komisioni. Ne kemi kërkuar arsyet pse shtesa është në nivel minimal.

G.C: Është fundi I vitit. Nuk kemi dashur të bëjmë ndryshime buxhetore. Kemi përdorur vetëm fondin që ka dërguar qeveria. Presim që të bëjmë shtesa kur të miratohet struktura e re.

B.T: Po shqyrtohen të gjitha mundësitë për ndryshimin e pozicioneve për nëpunësit civilë.

Gjithashtu krijimi I agjencive për pjesën e shërbimeve.

A.R: Ky është një vendim I ndërmjetëm I Këshillit.

Ne nuk veprojmë sipas nevojave. Ne duhet ta dimë organikën, rritjen e pagave sipas të ardhurave, etj.

B.T: VKM-ja thotë që niveli minimal përballohet nga fondi i kontigjencës, pa prekur të ardhurat e bashkisë.

F.G: Sa është numri i punonjësve dhe projekti për për numrin e tyre me strukturën e re?

B.T: Mendohet të ruhet numri duke përfshirë dhe agjencitë.

F.G: Në momentin që mban numrin dhe nuk rrit pagat, demotivon punonjësit. Nuk na duhen punonjës për zgjedhje. Kjo është ushtri elektorale dhe interes vote. Ju duhet jeni në kohën kur duhet të paraqisni buxhetin.

A.S: Kur janë bërë trajnimet e fundit të administratës së bashkisë?

B.T: Ne veprojmë në bazë të kalendarit të ASPA.

A.D: VKM-në 503 e keni zbatuar? Ke parashikuar inxhinierë më rrogë 40 mijë lekë...

B.T: Bazuar në këtë VKM po shqyrtojmë këtë projektvendim sot. Kemi sjellë por nuk ka ndryshime në strukturë.

A.D: Po kalon vetëm niveli i pagës dhe nuk do preket struktura e administratës. G.Sh: A e keni vendos me mbajt njerëz në Kukës apo jo?

E.Gj: Pse nuk janë rritur pagat për policinë bashkiake?

B.T: Nuk parashikohet nga VKM-ja policia bashkiake dhe punonjësit e shërbimeve.

Në projektbuxhetin e ardhshëm do të përfshihen.

E.Gj: Duhet të përlllogaritet vjetërsia për të gjithë njësoj.

A.M: Janë 7 shkolla të mesme që nuk kanë pastruese.

B.T: E kemi si informacion. Nuk është e përcaktuar se përse cfarë numër nxënësish të këtë sanitare.

Diskutime të tjera nuk ka.

A.R: Projekti ka cedime. Jemi të vonuar.

Hidhet në votim. Miratohet me 1 kundër (A), 1 abstenim(H) dhe të tjerët pro.

Vijohet me zgjedhjen e anëtarit përfaqësues në këshillin e qarkut.

Propozohen anëtarët e komisionit të votimit. Do të jenë 3 anëtarë.

B.Ll propozon E.Gj. V.M propozon G.H. A.D propozon XH.V.

Miratohet numri dhe përbërja e komisionit.

Propozohet për kandidatët. E.Gj propozon B.Ll.

H.P propozon G.O.

Vazhdon mbledhja me shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave ndërkohë që përgatiten materialet për zgjedhjet.

I kemi kërkuar urbanistikës një informacion por nuk është sjellë. Është mbledhur komisioni I ankesave dhe kërkesave. Kjo ankesë për punimet në lagjen 6 ka ardhur nga z. K.E I cili është I pranishëm sot në mbledhje.

K.E: Kam ardhur se më janë cënuar intereset e mia. Kjo kërkesë I ka kaluar afatet. Firma që po punon nuk ka leje ndërtimi. Tabelat për informacion nuk janë vendosur. E njejtat problematikë është bërë dhe me ujësjellësin. Nuk janë bërë dëgjesa me publikun. Kam dy prona me certifikatë pronësie. Punimet nuk janë cilësore. Ju jeni autoriteti që mund të bëni përgjegjës bashkinë.

A.G: Nese behen punime pa leje, si avokate me lind detyra per te bere nje kallzim penal. A.M: Ngritja e nje komisioni ad hoc per te gjitha investimet, sa anetare do te kete ne perberje?

Miratohet propozimi per 5 per ngritjen e ketij komisioni me 5 anetare.

Te verifikohet nese ka autorizim administrative, neni 44.

Hidhet ne votim ngritja e komisionit ad hoc. Miratohet.

Propozimet per anetaret e komisionit.

A.R propozon G.Sh.

F.G propozon H.P

R.T propozon E. Gj

D.S propozon G.H

E.Gj propozon Xh. V

H. P propozon V. M

Nga propozimet e bera u vendos te merren ne shqyrtim 5 kandidaturat e para.

A. D: Ideja është se cfarë do të prodhojë ky komision.

A. M: Ky komision miratohet me 16 vota.

Vijon diskutimi për gjendjen e infrastruktures, furnizimin me uje dhe energji elektrike.

Nga informacionet qe kam, te gjitha shkollat po furnizohen me lende djegese.

F. G: Me perpara ka qene mirembajtja ze me vete.

Arrni eshte pa energji elektrike. Duhet te ngrejme zerin edhe per probleme qe jane jashte kompetencave te bashkise. Duhet te jemi me solidarë.

E.H: Si anetar I komisionit te ankesave kemi shyrtuar ankesën për rehabilitimin e ujrave të zeza në lagjen 4.Kemi përfaqësues të ujësjellësit ne si drejtori kemi marrë masa kemi vendosur 4 puseta është rregulluar nga jashtë ,nuk mundemi të operojmë dot ,të bëjmë ndermjtësimin midis ministrisë dhe bashkisë ,behet fjalë për një tunel nntoksor

F.G; A ka pompa për ta tërhequr?,ju ngarkon ju detyrimisht

Perfaqesues I ujësjellësit ne nuk e kemi detyrim ligjor të ndërhyjmë ne pallate.

F.G:Është shkaktuar nga ju.

Duhet të sillni përfaqësuesit e firmës që kanë bërë punimet. Është bërë investimi nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Nuk jemi ne kontraktori.

A.M: Na e sillni informacionin me shkrim.

N.C : Kam ardhur me dy përfaqësues të pallatit .Problemi yne është i vazhdueshëm. Kam lobuar me te gjitha institucionet e mundshme për të gjetur zgjidhje. Ministria e Mbrojtjes dërgoi AKMC-në por ata kanë thënë se ky problem duhet të zgjidhet nga bashkia. Ky problem nuk është vetëm te shkalla jonë por në të gjithë lagjen 4 dhe 5. Kjo ka ardhur nga moszbatimi korrekt I projektit për rehabilitimin e lagjeve. Problemi përbën rrezik që mund të shkaktojë dhe shembjen e pallatit si dhe ndonjë epidemic të mundshme. Unë do ta adresoj cdo ditë derisa të zgjidhet ky problem. Ky ankim ka kaluar edhe te shërbimet publike të bashkisë dhe ata thonë që zgjidhja I takon ujësjellësit.

G.Sh: Cfarë mund të bëjmë dhe a ka marrë masa bashkia?

A.M: Si e mendon zgjidhjen drejtorja e ujesjellësit?

E.S: Ne mendojmë se duhet të ndërrohen të gjitha tubacionet e ujërave të zeza.

Problemi kryesor është brenda objektit.

A.R: A ka zgjidhje nga ana teknike dhe si mund të bëhet për efektet financiare?

Këta banorë nuk kanë asnjë faj. Duhet të gjendet një zgjidhje immediate. A bashkëpunoni ju me administratën e bashkisë?

M.K: Me një vendimmarrje të bëhet ndërhyrje dhe mbështetje e të interesuarve.

E.H: Kam një ankesë për parkimet te stadium. Duhet të vendoset një tratë sepse ka ankesa nga qytetarët. Bëhet zhurmë shumë e madhe.

A.M: Fletët e votimit janë gati. Vijohet me votimin për zgjedhjen e anëtarit përfaqësues për në Këshillin e Qarkut. Komisioni administron dokumentacionin. Vulosen fletët e votimit. Anëtarët e komisionit nënshkruajnë fletët e votimit.

Votohet sipas listës emërore anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Pas mbylljes së procesit të votimit, komisioni konstaton se kanë votuar 26 anëtarë. Në kuti u gjetën 26 fleta votimi.

Fillon numërimi.

Rezultati:

B.LI 20 vota

G.O 4 vota

Të pavlefshme 2 fletë.

Mbyllet mbledhja. Firmoset procesverbali.

Kukës, datë 02.12.2024

Kryetari i Këshillit

Albert Muja

Sekretari i Këshillit

Eridona Ramallari